

Republika e Shqiperise
Enti Rregullator i Sektorit te Energjise Elektrike

**LICENSE
PER VEPRIMTARINE
E SHPERNDARJES SE ENERGJISE ELEKTRIKE**

Seria: _____

Numri i Licenses: _____

Data e Hyrjes ne Fuqi: _____
(Vendim i ERE-s, Nr. _____, date ____ . ____ . ____)

Licensa i jepet: _____
(Emri dhe adresa)

Kodi fiskal: _____

Certifikata e Regjistrimit: _____
(Seria, Numri, Vendi i Regjistrimit)

Me autoritetin qe i eshte dhene sipas Pjeses se Trete te Ligjit nr. 9072, date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, te ndryshuar, Enti Rregullator i Sektorit te Energjise Elektrike (“ERE”) ja jep kete License Shperndarjeje (“Licensa”), per kryerjen e veprimtarise se shperndarjes se energjise elektrike (ShEE) me tarifa te rregulluara personit fizik/juridik te lart-permendur, i quajtur “I Licensuari”, subjekt i Kushteve te Licenses bashkangjitur kesaj License. Kjo License hyn ne fuqi ne daten e mesiperme dhe do te vazhdoje te mbetet ne fuqi per nje periudhe 30 vjeçare, deri sa te perfundohet nga i licensuari apo te hiqet nga ERE ne perputhje me kushtet e Licenses te perfshira ketu dhe legjislacionit ne fuqi. ERE do te percaktoje, jo me pak se nje here ne çdo pese vjet, nese jane permbushur kushtet e Licenses, dhe nese jo mund ta heq Licensen.

[Kryetari]

[Vula e ERE-s]

KUSHTET E LICENSES
Per
SHPERNDARJEN E ENERGIJISE ELEKTRIKE

Seria: _____ Nr. i Licenses _____

I jepet: _____
(Emri i plote i te Licensuarit)

1. Dispozita te Pergjithshme

- 1.1** ERE-ja eshte autoriteti i vetem ne Republiken e Shqiperise, i njohur sipas Pjeses se Trete te ligjit nr. 9072, date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, te ndryshuar qe leshon dhe deklaron hyrjen ne fuqi te kesaj License.
- 1.2** Nese ndonje kusht i kesaj License pushon se qeni efektiv, ai kusht do te hiqet nga Kushtet e Licenses dhe Kushtet e mbetura do te vazhdojne te jene ne fuqi.
- 1.3** Kjo License, nuk do t’i transferohet teresisht ose pjeserisht, asnje Personi tjetër pa miratimin paraprak me shkrim te ERE-s. Kur miraton nje transferim, ERE mund ta modifikojë periudhen e Licenses ose Kushtet e tjera te Licenses pasi te kete treguar nje arsye te bazuar.
- 1.4** ERE ndryshon Licensen ne perputhje me nenin 19 i Ligjit per Sektorin e Energjise Elektrike, si dhe ne rastet e meposhteme,
 - a.** nevoja per garantimin e mbrojtjes dhe sigurise kombetare si dhe te rendit publik pas marrjes ne konsiderate te pozicionit te autoriteteve shteterore kompetente;
 - b.** nevoja per te garantuar qendrushmerine dhe furnizimin e pandërprere me energji elektrike te klienteve;
 - c.** rreziku per jeten e qytetareve ose per demtimin e shendetit te tyre, si dhe demtimi i mjedisit ose demtimi i pasurise se paleve te treta, kur rreziku nuk kerkon heqjen e Licenses;
 - d.** ne License eshte bere nje gabim i qarte faktik; ose
 - e.** një ndryshim në kuadrin ligjor lidhur me tregun e energjisë elektrike përfshirë ndryshimet në kuadrin ligjor ose rregullat e zbatueshme për të Licencuarin që rrit materialisht koston e sigurimit të nivelit të shërbimit të kërkuar sipas kësaj Licence pa masa për shlyerjen e këtyre kostove nga i Licencuari.

- 1.5** I Licensuari mund të kërkojë një modifikim të kësaj License nëpërmjet një kërkesë të detajuar me shkrim që domosdoshmërisht duhet të përmbajë një justifikim për modifikimin e kërkuar. Një kërkesë e tillë mund të miratohet vetëm nëse i Licensuari tregon se modifikimi nuk do të çojë në ulje të çelësive të shërbimit, ose në rritje të çmimeve dhe tarifave për klientet apo përdoruesit e të Licensuarit. Në rast ERE do të kryej një procedurë modifikimi sipas nenit 19 të Ligjit nr.9072 datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
- 1.6** I Licensuari mund t’i parashtrijë ERE-s një kërkesë me shkrim për rinovimin e Licenses jo më pak se 6 muaj para përfundimit të afatit të Licenses së dhënë. Afati i Licenses do të zgjatet kur Bordi, bazuar në Ligjin nr.9072 datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Rregulloren për procedurat e licensimit dhe në prova të besueshme, konkludon se:
- a) I Licensuari i ka përmbushur kushtet e Licenses dhe i është përmbajtur kërkesave të gjithë legjislativitetit në fuqi gjatë afatit të licenses.
 - b) Rrjeti i Shpërndarjes do të operojë në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme gjatë afatit të rinovimit dhe kjo do të jetë në përfitim të klientit apo përdoruesve.
- 1.7** Në rast se Bordi refuzon ta rinovojë Licensen, deri në përfundim të saj, i Licensuari:
- i. nëse jepet miratimi nga ERE, mund t’ia transferojë pronësinë mbi asetet që përdor për kryerjen e veprimtarisë së Licensuarit një pale të tretë - blerësit. Asetet do të transferohen vetëm nëse, përveçse kur ERE, sipas ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, përcakton ndryshe; ose
 - ii. nëse jepet miratimi nga ERE, ja transferon operimin e veprimtarisë/faciliteteve të Licensuarit një subjekti që në gjykimin e ERE-s mund të ushtrojë veprimtarinë e Licensuarit nga ERE.
 - iii. Në rast se i Licensuari nuk e transferon pronësinë e aseteve para datës së përfundimit të Licenses fillestare dhe revokimi i Licenses mund të rezultojë me rrezik për mbrojtjen kombëtare dhe sigurinë, rendin publik dhe furnizimin e pandërprerë të klienteve me energji elektrike, ERE-ja me iniciativën e vet mund të caktojë një subjekt për kryerjen e funksioneve të të Licensuarit, që mund të jenë të nevojshme për performancën e pandërprerë të këtyre funksioneve.
- 1.8** Sipas Ligjit Nr.9072 Datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar , jepet vetëm një License për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike me tarifa të rregulluara në Republikën e Shqipërisë.
- 1.9** Fjalet dhe frazat e mëposhtme të përdorura në License, në Kushtet e Licenses dhe në Shtojcë, do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

Sherbimet Ndhimese	Gjithe sherbimet e nevojshme per operimin e sistemit te transmetimit dhe shperndarjes.
Biznesi Shoqerues	Çdo biznes qe direkt ose indirekt, teresisht ose pjeserisht: 1. zoterohet nga i Licensuari; ose 2. zoteron te Licensuarin; ose 3. zoterohet nga nje Person qe zoterohet nga i Licensuari.
Ligjit Nr.9072 Date 22.05.2003“Per Sektorin e Energjise Elektrike”	Do te thote ky ligj me te gjitha ndryshimet e ndodhura apo qe mund te ndodhin ne te ardhmen e qe ne vijim do te perdoret shkurtimisht me emertimin Ligji per Energjine.
Pagesat per Perdorimin e Rrjetit te Shperndarjes se Energjise Elektrike	Pagesat qe mund te vendose i Licensuari per perdorimin e Rrjetit te tij te Shperndarjes siç mund te miratohen nga ERE kohe pas kohe.
Ndersubvencionet	Transferimi i fondeve ose ndarja e kostove brenda llogarive te te Licensuarit ose mes Bizneseve Shoqerues per mbeshtetje financiare te nje veprimtarie ose biznesi me shpenzimet e nje tjetri.
Shperndarja	Transporti i energjise elektrike ne rrjete shperndarje te tensionit te mesem dhe tensionit te ulet (35 kV, 20 kV, 10 kV, 6 kV dhe 0.4 kV) per levrim tek klientet.
Rrjeti i Shperndarjes (RrSh)	Linja elektrike (zakonisht te tensionit te mesem dhe te ulet 35 kV, 20 kV, 10 kV, 6 kV dhe 0.4 kV), transformatore dhe pajisje shkyçese, qe perdoren per levrimin e furnizimit me energji elektrike tek klientet.
Energjia Elektrike	Energjia elektrike dhe kapaciteti elektrik, perveç kur konteksti e kerkon ndryshe.
Klient Tarifor	Nje person qe blen energji elektrike nga Furnizuesi Publik me Pakice me tarifa te miratuara nga ERE. Te gjithë personat qe blejne energji elektrike qe nuk jane Kliente te Kualifikuar jane Kliente Tarifore.

Klienti i Kualifikuar	Nje klient qe ka te drejten, sipas legjislacionit ne fuqi ose rregulloreve te ERE-s, te zgjedhe furnizuesin e energjise elektrike te perdorur per nevojat e tij.
Perdorues	Perosonat qe perdorin rrjetin dhe sherbimet e shoqerise se shperndarjes.
ERE	“ERE” do te thote Enti Rregullator i Sektorit te Energjise Elektrike ose enti rregullator pasues i tij.
Legjislacioni ne Fuqi	Ligjet e Republikes se Shqiperise te shpallura nga Kuvendi Shqiptar dhe qe jane ne fuqi gjate periudhes se kesaj License dhe cdo akt nenligjor i nxjerr ne zbatim te ligjit.
Sistemi i Shperndarjes	Perfshin zbarat, paisjet kycese, ckycese dhe transformatoret ne nenstacionet 110/35/20/10/6 kV si dhe te gjithe elementet ne nivel tensioni me te ulet se 110 kV ne pronesi te shoqerise se shperndarjes
Licensa per Shperndarjen e Energjise Elektrike	Eshte autorizimi qe i jepet nje personi sipas percaktimeve te Pjeses se Trete te Ligjit Nr.9072, date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike” te ndryshuar .
Veprimtaria e Licensuar	Veprimtari te nevojshme dhe direkt te lidhura me operimin e nje Rrjeti Shperndarje me qellimin e furnizimit me energji elektrike te klienteve me Tarifa te Rregulluara. Veprimtaria e Licensuar nuk perfshin aktivitetet e blerjes ose shitjes se energjise elektrike dhe kapacitetit, te cilat kryhen per klientet tarifore nga Furnizuesi Publik me Pakice.
I Licensuari	Personi qe mban kete License per Shperndarje te Energjise Elektrike qe permendet ne faqen e pare te kesaj License.
Personi	Person do te thote çdo person fizik ose juridik
Faktori i Humbjeve te Energjise	Humbjet e vleresuara te energjise elektrike ne rrjetin elektrik me nje tension te caktuar te shprehura ne perqindje te shumes totale te energjise elektrike te levruar ne rrjetin perkates brenda periudhes perkatese financiare.
Furnizuesi i Kualifikuar (FK)	Nje Person qe ka te drejten te furnizoje me energji elektrike Klientet e Kualifikuar siç percaktohet nga Legjislacioni ne Fuqi dhe Rregullat e ERE-s.
Tarifa e Rregulluar	Nje tarife aktualisht ne fuqi dhe e miratuar nga ERE sipas Legjislacionit ne Fuqi dhe Rregullave te ERE-s.
Rregulloret dhe Rregullat	Standardet, kodet, rregulloret, urdhrat dhe rekomandime te tjera ligjerisht ne fuqi te miratuara nga ERE.

Metodologjia e Llogaritjes se Koshtes se Sherbimit	Procedurat per llogaritjen e Tarifes se Furnizuesit te Kualifikuar(FK-se) te vendosura nga i Licensuari per lidhjet me facilitetet e tij te Rrjetit te Shperndarjes (RrSh-se). FK dhe KT do te paguajne te njejten tarife te RrSh qe i perket nivelit te tensionit ne te cilin jane te lidhur
Prodhuesi i Vogel i Energjise Elektrike	Prodhues i energjise elektrike nga nje central i lidhur me Rrjetin e Shperndarjes.
Transferimi	Transferim do te thote çdo shitje, dhenie me qira ose ndonje zgjidhje tjeter, teresisht ose pjeserisht, i se drejtes per t'u angazhuar ne Veprimtarine e Licensuar.
Operatori i Sistemit te Transmetimit (OST)	Personi i Licensuar pergjegjes per veprimtarite e transmetimit dhe dispeçerimit dhe procesin e kontrollit te operimit te impianteve gjeneruese dhe faciliteteve te tjera te industrise se energjise dhe burimeve per sigurimin e qendrushmerise se sistemit, sigurise, operimit te sigurt dhe eficient te sistemit elektroenergjetik.
Operatori i rrjetit	Strukture e Operatorit te Sistemit te Shperndarjes e cila kryen veprime te planifikuara ose jo ne Sistemin e Shperndarjes duke marre ne konsiderate programimin dhe ruajtjen e sigurise operative si dhe parametrate te cilesise sipas kushteve teknike.

2 Kryerja e Veprimtarise se Licensuar

- 2.1 I Licensuari autorizohet nga kjo License per kryerjen e Veprimtarise se Licensuar. Kjo e drejte i jepet ekskluzivisht te Licensuarit, pervec kushteve te Paragrafit 2.2.
- 2.2 Gjate afatit te Licenses, i Licensuari ka te drejte te kryeje te gjitha veprimtarite qe kerkohen per permbushjen e Veprimtarise se Licensuar, perfshire, pa kufizim:
 - a) ndertimin, operimin dhe zoterimin e asetave si pjese e Rrjetit me qellim zhvillimin e Rrjetit te Shperndarjes per sigurimin e energjise elektrike klienteve;
 - b) lidhjen e klienteve, dhe perdoruesve me Rrjetin e Shperndarjes;
 - c) instalimin dhe sherbimin e matesve te energjise elektrike
- 2.3 I Licensuari nuk do te vendose pagesa per klientet dhe perdoruesit, pervec kur autorizohet nga ERE.
- 2.4 I Licensuari nuk do te bashkepusoje ne asnje menyre me te Licensuar te tjere lidhur me Veprimtarine e Licensuar ne dem te furnizuesve ose klienteve dhe perdoruesve ekzistues ose te mundshem.
- 2.5 I Licensuari do t'i ndaje llogarite e veta financiare brenda periudhes kohore te kerkuar nga Legjislacioni ne Fuqi ne menyre qe t'i mundesoje ERE-s te konkludoje se nuk po ndodhin

ndersubvencione, veprimtari anti-konkurruese apo diskriminuese pervec kur lejohet ne menyre specifike nga ERE.

- 2.6 I Licensuari nuk do te angazhohet ne kryerjen e veprimeve ose ne ndonje aktivitet tjeter qe shkakton anti-konkurrence sipas Legjislacionit ne Fuqi.
- 2.7 I Licensuari do ta kryeje Veprimtarine e Licensuar ne perputhje me parimet e eficiences ekonomike dhe objektivin e arritjes se kosos me te ulet me standarde te percaktuara te cilesise dhe performances.
- 2.8 I Licensuari nuk do te angazhohet ne veprimtari te tjera, qe pengojne ose mund te pengojne kryerjen si duhet te Veprimtarise se Licensuar. I Licensuari do te njoftoje ERE-n para se te ndermarre ndonje veprimtari, pervec Veprimtarise se Licensuar. ERE-ja mund ta ndaloje te Licensuarin te kryeje ndonje veprimtari, pervec Veprimtarise se Licensuar, ose mund te vendose kushte per kryerjen e kesaj veprimtarie, qe jane te nevojshme per mbrojtjen e klienteve.
- 2.9 I Licensuari do te informoje ERE-n per ngritjen e cdo Biznesi shoqerues. ERE-ja mund ta ndaloje ose te vendose kushte per ngritjen e Biznesit Shoqerues, siq eshte e nevojshme per mbrojtjen e klienteve te Republikes se Shqiperise.
- 2.10 I Licensuari nuk do te pengoje, parandaloje ose te perpiqet te parandaloje te Licensuar te tjere apo konkurrues potenciale qe te angazhohen ligjerisht ose te hyjne ne biznesin e energjise elektrike ne Republikën e Shqiperise.

3. Detyrimet e te Licensuarit

- 3.1 I Licensuari do te respektoje Legjislacionin ne Fuqi gjate ushtrimit te funksioneve sipas kesaj license.
- 3.2 I Licensuari do te ndertoje dhe mirembaje Rrjetin e tij te Shperndarjes me kapacitet te pershtatshem per te plotesuar kerkesat e gjithe Klienteve dhe Perdoruesve brenda Shqiperise, perfshire zgjerimin ose permiresimin e faciliteteve te tij teknike sipas nevojës.
- 3.3 I Licensuari do te hartoje dhe nxise politika dhe programe per arritjen e nje niveli te larte te cilesise dhe qendrueshmerise se Sherbimeve te Shperndarjes sipas Rregullave te ERE-s.
- 3.4 I Licensuari do te ndermarre te gjithe masat e nevojshme per permiresimin e eficiences operative dhe ekonomike te Veprimtarise se Licensuar me qellim qe te siguroje cilesine dhe qendrueshmerine e sherbimeve te shperndarjes ne perfitim te klienteve, dhe sipas Kodit te Shperndarjes.
- 3.5 I Licensuari do te permbushe gjithe Rregullat e Operatorit te Sistemit te Transmetimit te miratuara nga ERE, perfshire zbatimin e gjithe urdhrave operative, udhezimeve si dhe paraqitjen e informacionit teknik dhe gjithe dokumentacionit tjeter sipas kerkesave te Kodit te Rrjetit dhe Rregullave te Tregut.
- 3.6 Per te lehtesuar kryerjen e Veprimtarive te Licensuara, i Licensuari mund te kerkoje te drejta te linjave elektrike ajrore dhe kabllore, te drejta perdorimi dhe shpronesimi sipas

Legjislacionit ne Fuqi. I Licensuari, sipas Legjislacionit ne Fuqi, ka te drejte te bleje toke, prona te tjera dhe te kryeje punime ndertimi per sa kohe qe keto veprime jane ne perputhje me Rregullat e ERE-s.

3.7 Llogarite dhe Raportimi

3.7.1 I Licensuari do te mbaje regjistra llogarie dhe do te pergatise pasqyra financiare, qe do te

mbahen me vete per Veprimtarine e Licensuar dhe çdo veprimtari tjetër (perfshire veprimtari te tjera te Licensuara) ku eshte angazhuar i Licensuari, sipas rregullave financiare dhe procedurave te miratuara nga ERE dhe sipas ligjit nr. 9228, date 29.04.2004, "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, neneve 21, 23 dhe 33 te Ligjit nr. 9072, date 22.05.2003 "Per Sektorin e Energjise Elektrike", te ndryshuar, dhe parimeve nderkombetare financiare. I Licensuari do t'i paraqese ERE-s raportin financiar vjetor ne 30 qershor te çdo viti.

3.7.2 Te Licensuarit i kerkohet te pergatise dhe t'i paraqese ERE-s ne 31 janar te çdo viti, nje raport vjetor lidhur me operimet e tij gjate vitit te meparshem kalendarik, qe permban sa me poshte:

- a) permbledhjen dhe analizen e veprimtarise se shperndarjes se te Licensuarit;
- b) shitjet e energjise elektrike dhe te dhenat mbi mbledhjen e faturave per vitin;
- c) cilesine e sherbimit te shperndarjes dhe detajet e çdo mase te marre per permiresimin e sherbimit te shperndarjes ne zone;
- d) çdo keq-funksionim qe ndodh gjate vitit;
- e) çdo nderprerje te programuar dhe te pa programuar te energjise elektrike sipas niveleve te tensionit
- f) Humbjet sipas niveleve te tensionit

3.7.3 I Licensuari do t'i paraqese ERE-s, me kerkesen e saj dhe sipas formes dhe brenda kohes se vendosur nga ERE, çdo informacion qe eshte i domosdoshem per ERE-n per te kryer pergjegjesite e saj rregullatore te autorizuar.

3.7.4 Licensuari do t'i ndaje shpenzimet e perbashketa mes Veprimtarise te tij te Licensuar dhe llojeve te tjera te veprimtarive (perfshire veprimtarite e Licensuara) ne baze te arsyeshme ne perputhje me paragrafin 3.7.1 te kesaj License dhe praktikat pergjithesisht te pranuar te biznesit. I Licensuari do t'i paraqese ERE-s, dokumentacionin qe percakton bazat per ndarjen e shpenzimeve te perbashketa si dhe rezultatet e arritura.

3.7.5 I Licensuari do ta njoftoje ERE-n brenda 10 diteve per çdo ndryshim te:

- a) Adreses;
- b) Statutit te te Licensuarit;
- c) Certifikates se regjistrimit;
- d) Kodit fiskal;
- e) Drejtuesve te larte; ose
- f) Aksioneve deri ne 5%.

3.7.6 Gjithe njoftimet zyrtare, aplikimet, peticionet dhe pretendimet qe lidhen me Licensen duhet te jene me shkrim, te ekzekutohen ne kohen e duhur nga nje zyrtar i autorizuar ose nje perfaqesues i zgjedhur i te Licensuarit ose ERE-s, perkatesisht, dhe te shperndahen me korrier ose me poste te regjistruar, duke kerkuar verifikimin e fatures. Adresat e Paleve duhet te duken mbi zarf. Te gjitha njoftimet ose korrespondenca tjeter do te konsiderohen se hyjne ne fuqi nga momenti i shperndarjes ose, nese nuk jane shperndare per shkak te gabimit te derguesit, nga momenti i paraqitjes.

3.8 Perdorimi i Informacionit

3.8.1 Sipas Ligjit te Energjise Elektrike, Kodit te Transmetimit, Kodit te Shperndarjes, Rregullave te Tregut dhe kerkesave te rregulloreve perkatese, I Licensuari do te siguroje qe çdo informacion i marre nga te tjeret si rezultat i Veprimtarise te tij te Licensuar nuk do t'i zbulohet askujt, perveç:

- a) me pelqimin paraprak me shkrim te Personit me çeshtjet e te cilit lidhet informacioni;
- b) kur informacioni eshte tashme i njohur per publikun;
- c) kur te Licensuarit i kerkohet ose i lejohet ta perhape informacionin per te permbushur Kushtet e kesaj License, çdo urdher te ERE-s, dhe Legjislacionit ne Fuqi.

3.8.2 I Licensuari do te siguroje qe asnje Biznes Shoqerues nuk do ta perdore informacionin ne pronesi te te Licensuarit per te fituar perparesi konkurruese te pajustificuar dhe do te siguroje se nuk do te perhape asnje informacion ndonje Personi tjeter (perfshire ata te nje Biznesi tjeter Shoqerues) qe mund ta mundesoje kete Person te arrije çdo lloj perparesie komerciale te pajustificuar.

3.8.3 I Licensuari do te hartoje dhe do t'i paraqese ERE-s procedura qe sigurojne respektimin e Paragrafeve 3.8.1 dhe 3.8.2. Me kerkesen e ERE-s, i Licensuari do te ndermarre çdo hap te nevojshem per ta mbrojtur informacionin konfidencial qe posedon dhe do t'i paraqese ERE-s raporte qe lidhen me respektimin e detyrimeve te parashikuara ne Paragrafet 3.8.1 dhe 3.8.2.

3.8.4 Informacioni qe i sigurohet ERE-s nga i Licensuari do te konsiderohet publik perveç, kur me kerkesen te veçante te te Licensuarit, ERE me vendim siguron se ky informacion eshte i natyres pasurore dhe se interesi publik te cilit i sherbehet nga perhapja e tij nuk do ta justifikojë ose kompensoje demin komercial potencial ndaj te Licensuarit.

3.9 Pagesat e Rregullimit

3.9.1 I Licensuari do te paguaje rregullisht dhe ne menyre te vazhdueshme pagesat e rregullimit gjate kohezgjatjes se kesaj License siç percaktohet nga ERE, sipas Nenit 12 te Ligjit nr. 9072, date 22.05.2003 "Per Sektorin e Energjise Elektrike" te ndryshuar dhe rregulloreve te ERE-s.

3.9.2 Nese i Licensuari nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit sipas paragrafit 3.9.1 brenda periudhes se kerkuar nga ERE, i Licensuari do te penalizohet sipas Nenit 64 te Ligjit nr. 9072, date 22.05.2003 "Per Sektorin e Energjise Elektrike" te ndryshuar.

3.10 Tarifa e Perdoruesit

3.10.1 Tarifa e Perdoruesit, te Rrjetit te Shperndarjes do te rregullohet dhe miratohet nga ERE ne perputhje me Metodologjine e Llogaritjes se Tarifese Shperndarjes. I Licensuari do te kerkoje axhustimin kohe pas kohe te Tarifese Perdoruesit per te pasqyruar koston reale.

3.10.2 Pagesa totale e Perdoruesit do te percaktohet ne baze te Tarifese Perdoruesit dhe sasise se energjise elektrike te regjistruar nga matesit e instaluar ne kufijte mes Rrjetit te Shperndarjes dhe klienteve te lidhur me Rrjetin e Shperndarjes, sipas Kodit te Matjes.

3.10.3 Tarifa e Perdoruesit, e miratuar nga ERE, do te vendoset duke marre ne konsiderate sigurimin e:

- a) te ardhurave te mjaftueshme per te mbuluar nivelet e arsyeshme te kostove operative dhe investimeve te justifikuar dhe te kujdesshme te realizuara, si dhe fitimeve te arsyeshme;
- b) nxitjes per reduktimin e kostove dhe operimin ne menyre eficiente.
- c) uljen e humbjeve

3.10.4 Gjate dy viteve te pare pas dates se hyrjes ne fuqi te çdo Tarife fillestare te Perdoruesit, i Licensuari do t'i propozoje ERE-s ndryshimin e Tarifese Perdoruesit per te permiresuar lidhjen mes strukturese çmimit dhe kostove aktuale per sigurimin e sherbimeve te shperndarjes.

3.10.5 I Licensuari do te paraqese raporte mbi tarifate sipas metodologjise se llogaritjes se tarifese shperndarjes te ERE-s. I Licensuari mund te sugjeroje ndryshime ne metoden e ndarjes se kostove qe perdoret per te percaktuar tarifate e zbatueshme per perdoruesit e rrjetit te shperndarjes, dhe qe do ta lejonin te Licensuarin te shlyente koston e arsyeshme dhe fitimet e sigurimit te ketyre sherbimeve. Metodologjia e ndarjes se kostove dhe çdo ndryshim i saj do te konsiderohet efektive vetem pas miratimit te saj nga ERE. Ky paragraf nuk perjashton autoritetin e ERE-s per te iniciuar ndryshimet e sieprcituara.

3.11 I Licensuari mund te kerkoje pagese sigurie te arsyeshme nga klientet sipas detyrave dhe pergjegjesive te tij gjate Veprimtarise se tij te Licensuar sipas Rregullave te zbatueshme te ERE-s. Detyrimet e sigurise do te deklarohen qarte ne kontratat mes te Licensuarit dhe klienteve apo perdoruesve te tij.

3.12 I Licensuari mund ta shkepuse nje klient per mos-pagese te faturave elektrike, sipas Rregullave te ERE-s dhe marrveshjeve me Furnizuesin Publik me Pakice. I Licensuari do ta rilidhe klientin apo perdoruesin pas pageses se faturave te papaguara, sipas Rregullave te ERE-s.

3.13 Aksesi ne Rrjetin e Shperndarjes

3.13.1 I Licensuari do t'u siguroje akses ne Rrjetin e Shperndarjes per t'u lidhur dhe per te perdorur asetet e Rrjetit te Shperndarjes, klienteve dhe perdoruesve te tij ne baze te drejte, te arsyeshme dhe jo-diskriminuese.

3.13.2 Brenda 15 diteve pas marrjes se kerkeses nga perdoruesi i rrjetit te shperndarjes, i Licensuari do te pergjigjet duke i siguruar aplikuesit informacion mbi lidhjet me rrjetin e

shperndarjes ose sherbime te tjera, perfshire informacion te detajuar mbi kushtet teknike, sherbimet dhe lejet shtese te nevojshme, kerkesat per matjen e energjise elektrike, perpunimin e te dhenave, pagesat, afatet dhe kushtet e marreveshjeve.

3.13.3 I Licensuari do t'i dergoje aplikuesit draftin e marreveshjes tip te miratuar nga ERE, brenda 15 (pesembedhjete) diteve pas marrjes se aplikimit per lidhjen ose per perdorimin e aseteve te Rrjetit te Shperndarjes. Brenda 15 diteve nga nenshkrimi i marreveshjes nga aplikuesi, i Licensuari do te perfundoje lidhjen per aplikuesin, pervec kur ERE lejon nje kohe me te gjate per nje arsye te bazuar te treguar nga i Licensuari. Ne rast te mosmarreveshjes midis paleve ato mund ti drejtohen ERE-s per zgjidhjen e mosmarevshjes sipas autoritetit te saj ne baze te ligjit per energjine.

3.13.4 I Licensuari nuk do te hyje ne asnje marreveshje qe mund te rezultojne ne shkelje te Kushteve te Licenses ose te ndonje dispozite te Kodit te Shperndarjes.

3.13.5 I Licensuari do t'u kerkoje perdoruesve te rinj te rrjetit te shperndarjes te paguajne pagesa te zbatueshme per lidhjen. I Licensuari do t'u jape perdoruesve te rrjetit te shperndarjes opsionin qe t'i paguajne pagesat e zbatueshme per lidhjen me nje pagese te vetme te te gjithes shumes ose me pagesa mujore te barabarta gjate nje periudhe te caktuar ne marreveshjen e lidhjes prej jo me pak se gjashte 6 muajsh dhe deri ne 2 vjet.

3.13.6 Gjate kryerjes se Veprimtarise se Licensuar, i Licensuari do t'i trajtojte perdoruesit e rrjetit te shperndarjes brenda se njejtës kategori apo nivel tensioni, ne menyre te drejte dhe jo-diskriminuese konform legjislacionit ne fuqi.

3.13.7 I Licensuari, sipas Kodit te Shperndarjes dhe rregulloreve te tjera perkatese, mund t'i pezulloje sherbimet e tij te siguruara sipas kesaj License per çdo periudhe gjate se ciles veprimi ose mosveprimi i nje ose me shume perdoruesve te rrjetit te shperndarjes se energjise elektrike kerconon sigurine, qendrueshmerine ose cilesine e operimeve te Rrjetit te Shperndarjes ose sherbimet e siguruara klienteve ose furnizuesve te tjere, ose parandalon ose pengon kryerjen e Veprimtarise se Licensuar nga i Licensuari ose gjate situatave te emergjences se furnizimit me energji elektrike siç percaktohet nga Legjislacioni ne Fuqi. Kur i Licensuari vepron sipas kesaj pike, do t'ia raportojte dhe informojte ERE-n brenda 24 oreve.

3.14 Nje mosmarreveshje mes te Licensuarit dhe perdoruesit te rrjetit te shperndarjes, dhe/ose nje te Licensuari tjetër lidhur me nje çështje brenda juridiksionit te ERE-s, qe nuk mund te zgjidhet nepermjet negociatave te kryera mes paleve do te vendoset nga ERE, pasi te jene degjuar palet para ERE-s, brenda qellimit te autoritetit te ERE-s dhe sipas Rregullave te ERE-s.

3.15 Nje vendim i ERE-s mund te apelohej ne Gjykatën e Rrethit Tirane sipas Legjislacionit ne Fuqi.

3.16 Matja e Energjise Elektrike dhe Humbjet

3.16.1 I Licensuari do te siguroje leximin e matesve te vendosur ne pikat e interkonjeksionit .

3.16.2 I Licensuari do të sigurojë sistemin e matjes, për klientet dhe përdoruesit e sistemit të të Licensuarit, përfshirë Furnizuesit e Kualifikuar dhe Furnizuesin Publik me Pakicë, në baza jo-diskriminuese dhe konfidenciale dhe do të kompensohet në mënyrë të arsyeshme për kostot përkatëse nga Tarifat e Përdoruesve.

3.16.3 I Licensuari:

- a) do të sigurojë që të gjithë klientet konform Kodit të Matjes të këne mates,
- b) do të mbajë një sistem për vlerësimin e sasisë së energjisë së konsumuar nga klientet për të cilët nuk merren leximet aktuale të matesit ose ato nuk përputhen saktësisht me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e ERE-s, por i Licensuari do t'i minimizojë në maksimum rastet kur kërkohen vlerësime;
- c) do të përcaktojë konsumin orar të energjisë për Klientet e Kualifikuar, që shërbehen nga Furnizuesit e Kualifikuar nëpërmjet matjes, vlerësimit të konsumit orar të ngarkesës ose me çdo metodë tjetër të pranueshme; dhe
- d) do të marrë miratimin e ERE-s për metodat dhe procedurat e përdorura për përcaktimin dhe vlerësimin e konsumit të energjisë elektrike.

3.16.4 I Licensuari është përgjegjës për blerjen e gjithë energjisë së nevojitur për të mbuluar humbjet në sistemin e shpërndarjes.

3.16.5 I Licensuari duhet të përgatitë një program për të arritur uljen e targetave të humbjeve ashtu siç është vendosur në metodologjinë e llogaritjes së tarifave të shpërndarjes apo nga ndonjë vendim tjetër i ERE-s.

3.16.6 I Licensuari do të bashkëpunojë me Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe do të sigurojë gjithë informacionin lidhur me operimin e Rrjetit të Shpërndarjes të kërkuar nga OST-ja. Kur leximet e matesve ose verifikimet duhen kryer nga OST-ja ose pala e autorizuar si duhet nga ERE, I Licensuari do ta lehtësojë aksesin në asetete e leximit të matesve brenda vendndodhjes së kompanisë së shpërndarjes.

3.16.7 I Licensuari do ta informojë dhe do të marrë miratimin e ERE-s të paktën një vit më parë mbi planet për ndryshime të mëdha në rrjetin e tij të energjisë elektrike, nëse këto ndryshime mund të çojnë në reduktimin e kapacitetit të rrjetit ose në uljen e qëndrueshmërisë së Rrjetit të Shpërndarjes. Me kërkesën e ERE-s, i Licensuari do t'i paraqesë ERE-s provat ekonomike dhe teknike të veprimeve të synuara.

3.17 Plani i zhvillimit të operimeve

3.17.1 Brenda gjashtë (6) muajve nga data e hyrjes në fuqi të Licenses, i Licensuari do të përgatitë dhe do t'i paraqesë ERE-s për miratim një plan zhvillimi të Operimeve që mbulon jo më pak se 3 (tre) vjet.

3.17.2 Plani duhet fokusuar në zhvillimin, rindertimin dhe rehabilitimin e Rrjetit të të Licensuarit me qëllim përmirësimin e shërbimit ndaj klienteve. Duhet të përfshijë, por nuk do të kufizohet me sa më poshtë:

- a) Një program ndertimi;
- b) Një program investimi me analiza tekniko - ekonomike dhe financiare për projektet e investimit;

- c) Nje program qe synon reduktimin e humbjeve te energjise elektrike ne Rrjet;
- d) Nje program mirembajtje per te siguruar, se bashku me programin e investimit, operim me te qendrueshem te Rrjetit;
- e) Treguesit e cilesise se sherbimit dhe nje program per te arritur synimet;

3.17.3 Programi i Rrjetit nuk duhet te diskriminoje ne menyre te paarsyeshme mes kategorive te klienteve. I Licensuari do t'i paraqese ERE-s nje here ne gjashte muaj nje raport qe tregon aktivitetet e tij lidhur me planin e Zhvillimit.

3.17.4 ERE, mund te zhvilloje seanca degjimore ne perfudnim te te cilave mund te kerkoje modifikime ne planin e zhvillimit te Operimit kur keto modifikime kerkohen per te siguruar plotesimin e detyrimeve sipas kesaj License.

4. Monitorimi dhe Kontrolltet mbi Performancen e Veprimtarise se Licensuar

- 4.1** ERE do te monitoroje respektimin nga i Licensuari te Kushteve te Licenses, do te rishikojte raportet e marra nga i Licensuari dhe eshte e autorizuar qe te inspektojte ne çdo kohe regjistrat financiare te te Licensuarit dhe mund te kerkoje nje auditim teknik dhe/ose financiar te veprimtarive te te Licensuarit.
- 4.2** Perfaqesuesit e autorizuar te ERE-s mund te hyjne ne ambientet, pajisjet dhe dokumentet e te Licensuarit per te inspektuar Veprimtarine e Licensuar sipas Rregullave te ERE-s. I Licensuari do te jape çdo ndihme te kerkuar nga ERE gjate ketij inspektimi.
- 4.3** Ne baze te ankeses se konfirmuar te çdo pale te trete ose me vete iniciativen e vet, ERE mund te nise nje hetim per respektimin nga i Licensuari te Kushteve te Licenses ose Rregullave te ERE-s.
- 4.4** Nese pas hetimit, ERE konkludon se i Licensuari nuk i ka respektuar Kushtet e Licenses, ERE mund t'i rishikojte tarifat e te Licensuarit dhe/ose te ndermarre veprime te tjera brenda autoritetit te saj me qellim qe te mbroje interesat e perdoruesve dhe klienteve ose te siguroje permbushjen e afateve dhe kushteve te kesaj License.
- 4.5** I Licensuari do ta informojte dhe sqarojte ERE-n per çdo shkelje te Kushteve te Licenses, jo me vone se nje jave pasi kjo shkelje i behet e njohur te licensuarit..
- 4.6** I Licensuari do t'u bindet vendimeve te nxjerra nga ERE, perfshire pagesat e gjobave te vena nga ERE, sipas Legjislacionit ne Fuqi.
- 4.7** I Licensuari eshte pegjegjes per zbulimin dhe parandalimin e vjedhjes se energjise.
- 4.8** Prokurimi ekonomik i aseteve dhe sherbimeve
 - 4.8.1** I licensari duhet te prokuroje asetet dhe sherbimet nga burimet me ekonomike duke pasur parasysh sasine dhe natyren e aseteve dhe sherbimeve.
 - 4.8.2** Cdo parashikim i aseteve apo sherbimeve i cdo mardhenie do te jene me terma afatgjate
 - 4.8.3** I Licensuari do te pergatise dhe do te mirembaje regjistrin e aseteve te te gjitha aseteve te domosdoshme

4.8.4 I Licensuari nuk do te shperndaje apo te zvogeloje kontrollin e veprimtarise mbi ndonje aset te domosdoshem pa miratimin e ERE-s

5. Heqja e Licenses

5.1 ERE mund ta heq Licensen sipas ligjit nr.9072, date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike” te ndryshuar dhe procedurave te percaktuara ne rregullat e ERE-s kur:

- a) I Licensuari kerkon heqjen e Licenses;
- b) I Licensuari shkel Kushtet e kesaj License perfshire mospagesen e tarifave qe kerkohen ne License;
- c) I Licensuari shkel Legjislacionin ne Fuqi;
- d) I Licensuari deklarohet i falimentuar dhe eshte i paafte te kryeje detyrimet sipas Kushteve te kesaj License.
- e) I Licensuari e ka marre Licensen me mashtrim.
- f) Mbaron afati i Licenses; ose
- g) Shkrihet personi qe mban Licensen.

5.2 Nese i Licensuari ndryshon statusin e tij ligjor ose aksioneri kryesor ndryshohet pa autorizim nga ERE, Licensa behet e pavlefshme dhe anulohet dhe pasuesi i te Licensuarit do te aplikojte per nje License te re sipas procedures se ERE-s per dhenie License.

5.3 I Licensuari eshte i detyruar te kryeje veprimtarite e specifikuara ne License. Nese gjate kryerjes se veprimtarise se Licensuar, shfaqen rrethana per te cilat i Licensuari ne menyre te arsyeshme nuk eshte ne gjendje te kryeje veprimtarite e specifikuara ne License, i Licensuari do te njoftoje menjehere ERE-n, dhe do te ndjek udhezimet e saj.

5.4 Kjo License mund te transferohet vetem me vendim me shkrim te ERE-s dhe sipas afateve dhe kushteve te vendosura nga ERE. Çdo vendim i ERE-s per ndonje transferim te kesaj License do te jete subjekt i gjykimit te ERE-s nese personi te cilit i transferohet licensa do te kete aftesine teknike dhe financiare per te plotesuar afatet dhe kushtet e kesaj License.

5.5 Çdo transferim i kesaj License pa miratimin e ERE-s do te anulohet dhe do te perbeje nje shkelje te kesaj License.

5.6 Kur Licensa perfundon si pasoje e shkeljeve nga i Licensuari te kushteve te Licenses, i Licensuari do te pergjigjet per koston e vendosur mbi ERE-n, Qeverine Shqiptare dhe pjesemarresit e tregut si rezultat i ketij perfundimi, siç percaktohet nga ERE, perfshire koston lidhur me transferimin e rregullt te Licenses tek nje i Licensuar i ri.

5.7 Kur ERE percakton se i Licensuari ka shkelur nje ose me shume kushte te Licenses, te Licensuarit do t’i jepet nje mundesi e arsyeshme per ta korrigjuar shkeljen para perfundimit te Licenses, perveç kur shkelja perfshin korrupsion ose pandershmeri te vertetuara nga organet me autoritetin perkates sipas ligjeve ne fuqi.

6. Operimi dhe mirembajtja e rrjetit

- 6.1** I Licensuari merr persiper operimin e Rrjetit te Shperndarjes ne menyre qe te siguroje furnizim te sigurt dhe te qendrueshem me energji elektrike, sipas rregullores teknike dhe kerkesave:
- a) duke perdorur pajisje qe plotesojne kushtet teknike, rregullat dhe standardet e sigurise;
 - b) duke perdorur nje numer te pershtatshem personeli te afte per te punuar per operimin dhe mirembajtjen e Rrjetit te Shperndarjes;
 - c) duke permbushur standardet kombetare, nderkombetare dhe te BE-se, te miratuara per zbatim ne Republiken e Shqiperise, dhe gjithe rregulloret e tjera teknike dhe standardet e miratuara nga organizmat kompetente.
- 6.2** I Licensuari merr persiper kryerjen e rehabilitimit dhe zhvillimit te Rrjetit te Shperndarjes me qellim qe te permiresoje sherbimin e Shperndarjes, sipas programeve ose planeve te miratuara nga ERE.
- 6.3** I Licensuari do t'i permbahet Legjilacionit ne Fuqi kur kryen aktivitetet e tij per projektimin dhe ndertimin e aseteve Rrjetit te Shperndarjes.
- 6.4** Pajisjet e blera nga i Licensuari me qellimin e rehabilitimit dhe rindertimit te Rrjetit te Shperndarjes duhet te jene specifikime me te mira performance se sa pajisjet ekzistuese dhe te jene ne perputhje me standartet e BE.
- 6.5** Ne rast defekti ose shkeputje, i Licensuari duhet ta ndreqe Rrjetin e Shperndarjes brenda periudhes kohore me te shkurter te mundshme. Nese fajin per vonesen e ka i Licensuari, ai do te mbaje pergjegjesi para klienteve te Rrjetit te Shperndarjes sipas kushteve te pergjithshme te kontratave te zbatueshme per sherbimin e Shperndarjes.
- 6.6** I Licensuari do ta menaxhoje Rrjetin e Shperndarjes ne menyre qe te permbushen dhe te ndiqen udhezimet e Operatorit te Sistemit te Transmetimit (OST) dhe te jene gjithnje ne perputhje me Kodin e Rrjetit.
- 6.7** I Licensuari do t'i komunikojte OST-se pa vonese gjithe ngjarjet dhe ndryshimet, perfshire defektet dhe shkeputjet qe mund te ndikojne mbi operimin ose integritetin e rrjetit te Transmetimit dhe sistemit te energjise elektrike, kur i Licensuari merr dijene per keto ngjarje. I Licensuari do t'i siguroje OST-se çdo informacion te kerkuar nga OST-ja sipas tarifes se OST-se dhe çdo kontrate te zbatueshme dhe rregullave te miratuara nga ERE.
- 6.8** Me qellimin e operimit, facilitetetet e te Licensuarit duhet te pershtaten me pajisjet teknike te telekomunikimit, matjes se larget dhe sinjalizimit dhe kontrollit defekt-masa parandaluese si dhe sistemit SCADA. I Licensuari do te siguroje ambientet e kerkuara, furnizimin me energji elektrike, ajrin e kondicionuar, sherbimin teknik dhe operativ te pajisjeve. I Licensuari do te projektojte, instaloje dhe siguroje mirembajtjen teknike te releve te mbrojtjes dhe pajisjeve te automatizuara qe kerkohen per operimin e qendrueshem te sistemit te Shperndarjes sipas kerkesave te Kodeve te Rrjetit

7. Kontrolli operues

7.1 I Licensuari do të sigurojë koordinimin dhe kontrollin e operimit të Rrjetit të Shpërndarjes dhe do t'i kryejë funksionet e veta në përputhje me rregullat e Rrjetit, legjislativitetin në fuqi dhe udhëzimet e OST-se.

7.2 Operatori i Rrjetit do të nxjerrë udhëzime verbalisht ose jo për personelin operues në detyrë të aseteve të Rrjetit, për klientet dhe Prodhuesit e Vegjel të Energjisë Elektrike të lidhur direkt me Rrjetin dhe këto udhëzime janë të detyrueshme për ta. Udhëzimet e Operatorit të Rrjetit së bashku me udhëzimet e OST-se do të regjistrohen në një regjister operimi, që duhet mbajtur për një periudhë prej të paktën [6 muajsh] dhe i bëhen të disponueshme ERE-s me kërkesë.

7.3 Operatori i Rrjetit do të mbajë një regjister dhe dokumente të tjera për punën e tij operative. Departamentet e menaxhimit të të Licensuarit do të përcaktojnë tipin e dokumenteve operuese, procedurat dhe kushtet e përgatitjes së tyre siç kërkohet nga legjislativiteti në fuqi

7.4 I licensuari do të instalojë sistemin SCADA

8. Shkëputja dhe ndërprerja e furnizimit me energji elektrike

8.1 I Licensuari mund ta ndërprejë ose ta kufizojë furnizimin me energji elektrike, pa e njoftuar më parë klientin, sipas udhëzimeve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, dhe me vendimin e tij:

- a) në rast të mungesës së energjisë ose për të parandaluar mungesën e energjisë;
- b) nëse shëndeti dhe jeta e njerëzve janë në rrezik;
- c) nëse integriteti i Rrjetit të Shpërndarjes vihet në rrezik;
- d) kur ka rrezik për demtim të rëndë të rrjetit ose pronesisë së blerësve të tjerë; dhe
- e) në rastet e emergjencës.

8.2 I Licensuari do të njoftojë klientet në mënyrë të pershtatshme dhe jo me vonë se afati i vendosur në aktet nëligjore të ERE, mbi arsyen e kufizimeve ose ndërprerjeve të furnizimit me energji elektrike dhe mbi periudhën kohore të kufizimit ose ndërprerjes.

8.3 I Licensuari ka të drejtë ta ndërprejë furnizimin me energji elektrike për një periudhë të arsyeshme kohë për qëllimet e kryerjes së riparimeve, shkëqjen operuese dhe venien në punë të pajisjeve të reja. Në këto raste i Licensuari do t'i njoftojë klientet për kohën e fillimit dhe zgjatjen e ndërprerjes të paktën 7 ditë para datës së veprimit nëpërmjet një njoftimi në media.

8.4 I Licensuari ka të drejtë ta ndërprejë furnizimin me energji elektrike të klientit pas njoftimit paraprak me shkrim kur:

- a) klienti konsumon energji elektrike por nuk zbaton kushtet e kontratës;
- b) klienti nuk ka paguar në kohë shumat e duhura për energjinë elektrike të përdorur siç kërkohet nga kushtet kontraktuale për shërbimet e Shpërndarjes ose për shërbimin me energji elektrike të siguruar nga Furnizuesi Publik; me Pakicë

- c) gjate nje kontrolli dhe pas verifikimit rezulton se per fajin e klientit:
- i) matesi nuk punon, gje qe ka shkaktuar mungesen e leximit, leximin e gabuar ose te pasakte dhe/ose matjen e pasakte te energjise elektrike;
 - ii) skema e lidhjes eshte prishur, gje qe mund te çojë ose ka çuar ne mungesen e leximit, leximin e gabuar ose te pasakte te matesit ;
 - iii) vulat, shenjat ose ndonje mekanizem tjeter kontrolli, te vendosura nga i Licensuari ose ndonje organizem shteteror i autorizuar, jane demtuar ose shkaterruar;
- d) klienti:
- i) ka lejuar perdorimin e energjise elektrike qe nuk eshte matur me mates;
 - ii) ka lejuar kliente te rinj te energjise elektrike qe te lidhen pa njoftuar dhe pa marre leje nga i Licensuari;
 - iii) nuk i siguron akses personelit te te Licensuarit per te lexuar ose kontrolluar matesin.

8.5 Afati ne njoftimin me shkrim per pagesen nuk do te jete me i shkurter se 7 (shtate) dite pas dates se marrjes se njoftimit nga klienti. Njoftimi per pagesen do te permbaje informacion mbi arsyen e vendosjes se pageses, mbi shumat e detyrueshme, periudhen kohore per interesat e detyrueshme dhe afatin e pageses.

8.6 Nderprerja e furnizimit me energji elektrike sipas ketij nenseksioni do te zgjase deri sa klienti te shmange arsyen qe justifikonte nderprerjen, dhe ne kete rast sherbimi do te rikthehet jo me vone se 48 ore pas shmangies se arsyes.

9. Cilesia e sherbimit

9.1 I Licensuari do ta planifikoje, operoje dhe zhvilloje Rrjetin, duke siguruar cilesine e sherbimit sipas rregullave te Rrjetit dhe Kodit te Shperndarjes te miratuar nga ERE.

9.2 Gjate kryerjes se veprimtarise se Licensuar , i Licensuari do te drejtohet nga treguesit e cilesise se sherbimit dhe synimet e detyrueshme per zhvillimin e Rrjetit te Shperndarjes te vendosura ne planet e miratuara nga ERE.

9.3 Brenda nje viti pas dates se hyrjes ne fuqi te Licenses, i Licensuari do te propozoje tregues te detyrueshem per cilesine e sherbimit per nje periudhe te caktuar, se bashku me gjobat dhe shperblimet per mospermbushjen dhe per tejkalimin e standardeve te vendosura ne tregues. Keta tregues do te kerkojne nga i Licensuari permiresimin e standardeve te cilesise se sherbimit. ERE do t'i rishikojë dhe miratojë keta tregues dhe do te kete autoritetin per te kerkuar zbatimin e tyre.

9.4 I Licensuari do t'i paraqese çdo vit ERE-s nje raport qe pershkruan performancen e tij lidhur me treguesit e cilesise se sherbimit te cilet miratohen nga ERE.

10. Marredheniet me klientet

10.1 I Licensuari do te hartojë dhe ERE do te miratojë, afatet dhe kushtet e pergjithshme qe rregullojne marredheniet e tij me klientet. I Licensuari mund te kerkojë modifikimin e ketyre afateve dhe kushteve te pergjithshme, qe jane gjithashtu objekt i rishikimit dhe miratimit nga ERE.

10.2 I Licensuari do t'i beje te dukshme afatet dhe kushtet ne te gjitha zyrat e tij, do t'i publikoje ne faqen e tij te internetit, dhe do t'u jape klienteve mundesine te marrin nje kopje te dokumentit.

10.3 I Licensuari do te publikoje, do te vendose ne faqen e tij te internetit dhe do t'u jape klienteve informacion te detajuar mbi çmimet dhe tarifat e energjise elektrike per kategori te ndryshme klientesh.

10.4 I Licensuari do t'u jape klienteve fatura te detajuara sipas kerkeses, dhe do te mbaje dokumentacion te mjaftueshem per te mbeshtetur shumat e faturuara.

10.5 I Licensuari do te krijojte ne strukturen e kompanise nje njesi te dedikuar per mardheniet me klientet. I Licensuari duhet te punesoje nje numer te mjaftueshem personeli te kualifikuar siç duhet per kete njesi.

10.6 Brenda 6 (gjashte) muajve pas dates se hyrjes ne fuqi te Licenses, i Licensuari do te pergatise rregulla per te trajtuar ankesat e klienteve dhe do t'ia paraqese keto rregulla ERE-s. Rregullat do te perfshijne te pakten sa me poshte:

- a) te dhena mbi organizimin e njesise se dedikuar, perfshire vendndodhjen, oret e punes, oret per takimet me klientet, numrin e telefonit te kontaktit, etj.;
- b) afatet dhe kushtet per lidhjen e klienteve me Rrjetin e Shperndarjes , aplikimet per hetimin e kushteve dhe procedurave per lidhjen e klienteve me Rrjetin e Shperndarjes , periudhat e kontrollit dhe pergjigjes, proceduren e refuzimit, perfshire paraqitjen e formave te aplikimit, etj.;
- c) kerkesat minimale teknike per lidhjen e faciliteteve te gjeneratoreve te pavarur, instalimeve dhe rrjeteve te klienteve ne Rrjetin e Shperndarjes;
- d) afatet dhe kushtet per perfundimin e kontratave per shitje te energjise elektrike me Kushte te pergjithshme;
- e) afatet dhe kushtet per te paraqitur pretendimet, aplikimet dhe propozimet; dhe
- f) procedurat dhe afatet per hetimin dhe pergjigjen ndaj ankesave, aplikimeve dhe propozimeve te regjistruara.

10.7 Proceset dhe rregullat e vendosura sipas paragrafit f) me lart, do te behen publikisht te disponueshme, perfshire faqen e internetit te te Licensuarit dhe do t'u jepen klienteve me kerkesa.

10.8 I Licensuari do te mbaje dokumentacionin qe permban gjithe ankesat, aplikimet dhe propozimet dhe pergjigjet per secilen prej tyre per nje periudhe 3 (tre) vjeçare pas dates se marrjes ose pergjigjes, kushdo qofte me e vonshme.

10.9 I Licensuari do te ngreje nje sistem per regjistrimin dhe trajtimin e ankesave, aplikimeve dhe propozimeve te klienteve.

10.10 I Licensuari do te marre ne konsiderate çdo ankese dhe do t'i pergjigjet me shkrim ankuesit per ta keshilluar nese ankesa e tij/saj eshte pranuar apo refuzuar, brenda 15 diteve pune nga marrja e saj.

10.11 Ne rast se i Licensuari nuk pergjigjet brenda periudhes se treguar ose pergjigja nuk e kenaq ankuesin, ankesat, aplikimet dhe propozimet mund t'i adresohen ERE-s. Nese ERE, pas marrjes se mendimit te te Licensuarit, vendos se ankesa specifike eshte e justifikuar, do t'i jape te Licensuarit udhezime te detyrueshme.

10.12 I Licensuari do t'i paraqese ERE-s ne raportin e tij vjetor, informacion te detajuar lidhur me:

- a) numrin total te ankesave, aplikimeve dhe propozimeve gjate vitit te kaluar kalendarik;
- b) ndarjen e ankesave, aplikimeve dhe propozimeve sipas kategorive si mosplotesimi i aplikimeve per sherbime, cilesia e sherbimit, etj.; dhe
- c) menyren per zgjidhjen e ankesave, si: ngarkimi per riparimin ose kompensime paguar ankuesve dhe arsyet e refuzimit te ankesave, etj.

11. Siguria ne pune dhe operimi i sigurt i rrjetit

11.1 I Licensuari do ta operoje, mirembaje dhe zhvilloje Rrjetin e Shperndarjes ne menyre qe çdo rrezik i parashikuar per personelin, klientet ose persona te tjere, te eliminohet ne shkallen me te larte te mundshme ne kushte normale operimi dhe ne raste defektesh.

11.2 I Licensuari do te permbushe gjithe kerkesat aktuale teknike, rregulloret dhe standardet lidhur me:

- a) operimin dhe mirembajtjen e Rrjetit te Shperndarjes, pajisjeve dhe aseteve te perdorura per kryerjen e veprimtarise se Licensuar;
- b) operimin dhe mirembajtjen e matesve ; dhe
- c) riparimet e sistemit.

11.3 Lidhur me performancen e tij sipas seksionit te meparshem i Licensuari:

- a) do te hartoje dhe zbatoje manuale te brendshme per operimin e Rrjetit te Shperndarjes dhe aseteve
- b) do te punesoje nje numer personeli te kualifikuar si duhet per operimin dhe mirembajtjen e Rrjetit, instalimeve, pajisjeve, faciliteteve dhe matesve komerciale.

11.4 I Licensuari do t'u permbahet ligjeve, rregulloreve. dhe standardeve te shendetit dhe sigurise ne pune dhe:

- a) do te fuse dhe mirembaje rregullore te brendshme te pershtatshme lidhur me shendetin dhe sigurine e personelit te tij sipas legjislacionit ne fuqi ;
- b) do te siguroje gjithe rrobat e nevojshme mbrojtese te punes, mjetet dhe materialet mbrojtese; dhe
- c) do te siguroje kushte te mira sanitare dhe kujdes mjekesor per punetoret dhe nepunesit sipas standardeve dhe kerkesave te higjienes.
- d) Detyrimet e mbrojtjes se mjedisit
- e) Detyrimet e shendetit publik te aplikueshme per te gjithe perdoruesit e rrjetit te shperndarjes, duke perjashtuar ato qe jane tashme te mbuluara nga mbajttesi i licenses se furnizuesit publik dhe qe aplikohen per klientet tarifore.

12. Situatat e Emergjences

12.1 I Licensuari nuk do te konsiderohet sikur i ka shkelur kushtet e kesaj License ne rast se parandalohet ne permbushjen e tyre nga forca madhore ose rrethana te tjera emergjence.

12.2 Ne kushtet e emergjences, i Licensuari:

- a) do te ndermarre veprimet e duhura per te garantuar qendrueshmerine e ndertimit, mirembajtjen dhe operimin e Rrjetit te shperndarjes;
- b) do te siguroje bashkepunimin e nevojshem me autoritetet dhe institucionet pergjegjese per te vepruar ne situate emergjence, me qellim qe te rifilloje furnizimin e demtuar me energji elektrike brenda nje periudhe kohore sa me te shkurter;
- c) do te plotesoje detyrimet e tij per reduktimin e rreziqeve dhe humbjeve lidhur me jeten, shendetin dhe pronen e paleve te treta;
- d) do te marre masa te menjehershme per te marre pjese brenda nje periudhe kohore sa me te shkurter ne restaurimin e Rrjetit te shperndarjes qe eshte shkaterruar ose demtuar si rezultat i ketyre rrethanave te emergjences;
- e) Brenda 24 oreve nga ngjarja qe perben emergjence, i Licensuari do te njoftoje ERE-n per situaten e emergjences dhe veprimet qe do te ndermarre per ta kthyer sistemin ne operim normal.

12.3 Nese i Licensuari e parashikon situaten e emergjences siç percaktohet nga Legjislacioni ne Fuqi, i Licensuari do te njoftoje ERE-n brenda 24 oreve dhe ky njoftim do te pershkruaje se çfare hapash do te marre i Licensuari per te menjanuar ose permiresuar ndikimet e situates emergjente te parashikuar.

13. Zgjidhja e Mosmarreshjeve dhe e Drejta per Apel

13.1 Çdo çeshtje e diskutueshme ose pretendim mes te Licensuarit dhe çdo Perdoruesi lidhur me Kushtet e Licenses do te zgjidhet me mirekuptim midis paleve, sipas Legjislacionit ne Fuqi.

13.2 Nese zgjidhja nuk arrihet me mirekuptim midis paleve, atehere ERE ne baze te petitionit te çdo Personi qe eshte pale ne kete mosmarreshje, do ta zgjidhe mosmarreshjen dhe do nxjerre vendimin e saj sipas Legjislacionit ne Fuqi.

13.3 I Licensuari mund t'i apeloje vendimet e ERE-s siaps legjislacionit ne fuqi ne Gjykatën e Rrethit Tirane brenda 30 diteve nga publikimi i vendimeve ne Fletoren Zyrtare.

13.4 I Licensuari duhet te zbatoje vendimet e ERE-s ne pritje te shqyrtimit para Gjykates se Rrethit Tirane.

Republika e Shqiperise
Enti Rregullator i Energjise Elektrike

LICENSE
Per
SHPERNDARJEN E ENERGIJISE ELEKTRIKE

Licensa i jepet:

(Emri i plote i te Licensuarit)

Seria: _____ Nr. i Licenses: _____

Data e hyrjes ne fuqi te kesaj Shtojce: _____